



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

-Kuvendi Komunal

01 Nr.06-2025/1

Dt.18.12.2012

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 32 të Statutit të Komunës-
Dragash,pas shqyrtimit paraprak të Propozimit për revidimin e Vendimit për „Varrezat e Qytetit“ 01
Nr.06-61/2 të dt.07.05.2009,Kuvendi Komunal i Dragashit,në seancën e mbajtur më 18.12.2012,miraton
këtë.

V E N D I M

1. **MIRATOHET** Propozimi kryetarit të Komunës-Dragash për revidimin e vendimit për
„Varrezat e Qytetit“ 01 Nr.06-61/2 i dt.07.05.2009 dhe caktohet sipërfaqja e re për “Varrezat
e Qytetit” në sipërfaqe prej 80 ari në vendin e quajtur “Polje-pod groblje” në pjesën
parc.kadastrale 528 ZK Dragash,e cila evidentohet sipas listës poseduese 179,në emër të
pronës shoqërore-Kuvendi Komunal,në pjesën përfundimtare të kufirit të parcelës të varrzave
ekzistuese lokale të Dragashit në par.kadastrale 539,që evidentohet në emër të pronës
shoqërore-Kuvendi Komunal,sipas listës poseduese 161.
2. Përcaktohet hyrja në varreza përmes par.kad.538 që evidentohet sipas l.poseduese 186 në
emër të pronës shoqërore-Kuvendi Komunal-,si dhe përcaktohet hyrja sipas rrugës
ekzistuese faktike te kufiri isipërm i parcelës 539 në pronësi të të varrezave lokale të
Dragashit në gjerësi 3m dhe gjatësi 57 m.
3. Lokacioni i “Varrezave të Qytetit” është e caktuar në harmoni me Planin Hapësinor të
Dragashit,aktet normative mbi mbrojtjen e mjedist,siç janë rregullat për mbrojtjen e
ujit,puseve,mbrojtjen e ajrit dhe në harmoni me kushtet sanitare.
4. “Varrezat e Qytetit” do të shfrytëzohen nga të gjithë qytetarët e-Dragashit.
5. Institucionet dhe shërbimet kompetente të Komunës-Dragash nga buxheti komunal ose
donacionet,në radhë të parë do të rrethojnë sipërfaqen e përcaktuar e pastaj do të bëjnë
adaptimin,aftësimin dhe hapjen e rrugës deri te “Varrezat e Qytetit”.

6. Arqitektura e vendit për varrim,projekti i rregullimit të pjerrtësive do të bëhet në bazë të rregullimeve detale të planeve dhe rregullores së posaçme të Bashkësis Islame.
7. Mirëmbajtja dhe ruajtja e “Varrezave të Qytetit” dhe vendeve tjera për varrim në teritorin e Komunës së Dragashit do të rregullohen në bazë të rregullores së posaçme që do t’a harton Komuna dhe do t’a miraton Kuvendi Komunal,e gjithë kjo në bashkëpunim me Bashkësinë Islame.
8. Ky Vendim hynë në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal i Dragashit, përkatësisht në ditën e nënshkrimit nga kryesuesi i Kuvendit.
9. Për zbatimin e këtij Vendimi përkuajdesen kryetari i Komunës .

Shtojcë: Raport-Propozimi...

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtoratit të Urbanizmit...,dhe
- Arkivit

KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH

Kryesuesi
Lulzim Rifaj

